

**UDHËZUES
KOMPETENCAT E AUTORITETEVE
VENDORE
PËR PARANDALIMIN
E KRIMIT MJEDISOR**

Dhjetor 2019



UDHËZUES

KOMPETENCAT E AUTORITETEVE

VENDORE PËR PARANDALIMIN E

KRIMIT MJEDISOR

Dhjetor 2019

PROCEDURAT STANDARDE OPERACIONALE PËR ZYRTARËT VENDORË PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E PYJEVE, AJRIT, UJIT DHE TOKËS

Ky udhëzues u përgatit në emër të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrive të linjës, përmes Grupit Ndër-institucional kundër Krimit Mjedisor në konsultim me përfaqësues të Shoqatave të Bashkive, Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, bashkive dhe Grupit Këshillimor të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fushën e parandalimit dhe ndërgjegjësimit kundër krimit mjedisor në Shqipëri. Botimi u mbështet nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri.

www.osce.org/albania

© “Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali mund të përdoret apo riprintohet lirisht për qëllime edukuese dhe jo-komerciale, duke konsideruar që riprodhimi të shoqërohet me njohjen e OSBE-së si burim i parë.”

Autor: Olsi ÇOKU, ekspert ligjor

Udhëhoqi grupin e punës: Elton QËNDRO, këshilltar për qeverisjen vendore, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Kontribuan: Anila LEKA, Adriana PETRI, Bledar DOLLAKU, Enerita TARELLI, Enis TELA, Klodiana MARIKA, Mariel HALILAJ, Ndrëçim BYTYÇI, Luan MEMA, Petrit BADUNI

Punimet grafike dhe shtypi: Graphic Line-01

Redaktimi gjuhësor: Rubin VOJKA

Redaktimi dhe përgatitja për botim: Elton QËNDRO, Këshilltar për Qeverisjen Vendore, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

ISBN:

Mohim: Përmbajtja e raportit është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron pozicionin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

FALËNDERIME

Udhëzuesi “Kompetencat e autoriteteve vendore për parandalimin e krimit mjedisor” është hartuar dhe bashkërenduar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me kontributin e Grupit Ndërinstitucional kundër Krimit Mjedisor të ngritur me Urdhrin e Ministrit Nr. 15, datë 21.01.2015 dhe drejtuar nga Zv. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Ornela Çuçi.

Ky udhëzues u mbështet në të gjitha fazat përgatitore deri në finalizimin e saj nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dëshiron të falënderojë Grupin Ndërinstitucional kundër krimit mjedisor: Znj. Klodiana Marika, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Anila Leka, Prokuroria e Përgjithshme, Z. Agron Mema, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Znj. Adriana Petri, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Z. Bledar Dollaku, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Z. Enis Tela, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Z. Luan Mema, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Z. Mariel Halilaj, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Z. Ndrëçim Bytyçi, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Z. Petrit Baduni, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, dhe znj. Enerieta Tarelli, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Falënderojmë gjithashtu ekipin e ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve nga bashkitë dhe Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore që dhanë kontribut për hartimin e këtij udhëzuesi.

PËRMBAJTJA

I. Hyrja

II. Kuptimi i krimit mjedisor dhe legjislacioni i zbatueshëm 11

II.1. Diskutim i përgjithshëm për veprat penale në fushën e mjedisit	21
--	----

III. Kompetencat funksionale dhe përgjegjësitë konkrete të bashkive dhe organeve të tyre të varësisë 22

III.1. Marrja dijëni dhe kallëzimi i fakteve penale/krimeve që ndotin apo dëmtojnë mjedisin	37
---	----

IV. Procedurat Standarde Operacionale (PSO) të tre sektorëve të posaçëm 38

PSO 1: Mbrojtja e ujit, ajrit dhe tokës nga ndotja	41
--	----

PSO 2: Mbrojtja e natyrës dhe pyjeve	49
--------------------------------------	----

PSO 3: Kontrolli i mbetjeve përfshirë mbetjet spitalore dhe ato të rrezikshme	55
---	----

IV.2. Të drejtat e bashkisë për të kërkuar dëmin e shkaktuar	57
--	----

Aneksi I. Baza ligjore e kompetencave të pushtetit vendor 59

Aneksi II. Kallëzimi nga nëpunësit publikë 65

UDHËZUESI “KOMPETENCAT E AUTORITETEVE VENDORE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT MJEDISOR” DHE PROCEDURAT STANDARDE OPERACIONALE PËR ZYRTARËT VENDORË PËRGJEGJËS PËR MBROJTJEN E PYJEVE, AJRIT, UJIT DHE TOKËS

Përshkrim i përgjithshëm

Ky udhëzues do të jetë në dispozicion të zyrtarëve vendorë që trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë çështjet që lidhen me krimin mjedisor në përditshmërinë e tyre. Doracaku do të sigurojë informacione praktike në lidhje me kompetencat vendorë, ndërveprimin e tyre me kompetencat e autoriteteve qendrore në fushën e krimeve mjedisore dhe gjithashtu do të përmbajë tre Procedura Standarde Operacionale (PSO). Pikërisht këto PSO do të vendosen si shtojca të Udhëzuesit, mbi të cilat do të mbështetet dhe ndërtohet qasja organizative dhe ndërhyrëse e strukturave përgjegjëse për trajtimin e problematikave të krimit mjedisor.

PSO-të do të përbëhen nga një grup udhëzimesh me shkrim për zyrtarët e bashkive dhe strukturat e tyre të varësisë, duke synuar lehtësimin e veprimtarisë parandaluese, zbuluese dhe hetimin e krimeve mjedisore në Shqipëri në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm administrativ dhe penal.

I. Hyrja

Krimi mjedisor përbëhet nga aktivitete të paligjshme që dëmtojnë mjedisin për qëllim të përfitimit të grupeve apo individëve nëpërmjet shfrytëzimit dhe/ose shkatërrimit të burimeve natyrore, ujit, ajrit, tokës apo dëmtimit të zonave të mbrojtura. Veprimet dhe mosveprimet që shkelin legjislacionin mjedisor dhe shkaktojnë dëme të konsiderueshme ose rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut klasifikohen përgjithësisht si kundërvajtje administrative, por në një pjesë të mirë të rasteve janë krime të mirëfillta mjedisore. Ky udhëzues ka për qëllim të referojë dhe trajtojë të gjitha këto veprime apo mosveprime të dëmshme ndaj mjedisit që klasifikohen si krime mjedisore.

Për të trajtuar dhe strukturuar të gjithë listën e kompetencave, paqartësitë e përgjithshme dhe të veçanta të detyrave funksionale të zyrtarëve vendorë në fushën e krimit mjedisor, është hartuar ky Udhëzues me qëllim shpjegimin e atyre kompetencave që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendorë (NjQV) kanë për të identifikuar dhe trajtuar krimet mjedisore sipas përcaktimit të secilës vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

Udhëzuesi shpjegon të gjithë ato copëza legjislacioni që mund dhe duhet të përdoren gjatë veprimtarisë së autoriteteve vendorë dhe ofrojnë një bazë ku mund të mbështetet puna për identifikimin dhe raportimin e krimeve mjedisore në nivel vendor, me qëllim fundor parandalimin e krimit mjedisor; ndjekjen e shkeljeve administrative dhe të krimeve mjedisore; dhe zbutjen e dëmit mjedisor.

Në të njëjtën kohë, udhëzuesi synon të rrisë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të ndryshme të zbatimit, që janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të nxisë bashkërendimin me aktorët e tjerë, në ndjekjen dhe hetimin e rasteve të papajtueshmërisë, në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe atë penal.

Veç informacionit të mësipërm, udhëzuesi siguron informacione

praktike për tre Procedura Standarde Operacionale (PSO) që do të vendosen si shtojca të Udhëzuesit, mbi të cilat do të mbështetet dhe ndërtohet qasja organizative dhe ndërhyrëse e strukturave përgjegjëse për trajtimin e problematikave të krimit mjedisor. PSO-të do të përbëhen nga një grup udhëzimesh me shkrim për zyrtarët e bashkive dhe strukturat e tyre të varësisë, duke synuar lehtësimin e veprimtarisë parandaluese, zbuluese dhe hetimin e krimeve mjedisore në Shqipëri, në përputhje me kompetencat e dhëna atyre nga legjislacioni i zbatueshëm administrativ dhe penal sipas sektorëve më poshtë:

- Udhëzues për kontrollin e ndotjes së ajrit, tokës dhe ujit;
- Udhëzues për mbrojtjen e natyrës dhe pyjeve;
- Udhëzues për kontrollin e mbetjeve.

Metodologjia e përdorur ka përfshirë kryesisht kërkimin dokumentar dhe zhvillimin e intervistave të drejtpërdrejta, apo nëpërmjet telefonit, me nëpunës të ndryshëm në Ministrinë e Linjës, Ministrinë e Mjedisit dhe me përfaqësues të bashkive, si institucione që kanë brenda fushës së administrimit pyjet dhe kullotat. Kërkimi dokumentar ka përfshirë analizën e ligjeve, akteve nënligjore dhe dokumenteve të tjerë (materiale informuese, raporte, udhëzues të ndryshëm etj.) për zbatimin e legjislacionit në fuqi për identifikimin, parandalimin apo ndëshkimin e krimit mjedisor në Shqipëri në nivel vendor.

Metodologjia kryesore e përdorur gjithsesi mbetet krahasimi analitik dhe rregullator i ligjeve dhe akteve ligjore e nënligjore ekzistuese, me qëllim identifikimin e mbivendosjes ose konfliktit midis klauzolave në ligjet sektoriale dhe përcaktimeve në ligjin kuadër.

II. Kuptimi i krimit mjedisor dhe legjislacioni i zbatueshëm

Në kuptimin e zakonshëm, krimi mjedisor nënkupton të gjitha veprimet që i shkaktajnë dëm mjedisit. Mirëpo, në kuptimin ligjor, ky përcaktim mund të kuptohet në mënyrë të përmbledhur si *“tërësia e dispozitave që vendosin përgjegjësinë penale (apo administrative/civile kur nuk kemi të bëjmë me veprë penale) për sjelljet e caktuara që shkaktajnë dëm ndaj mjedisit, qoftë ky i mundshëm apo i efektshëm”*.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon në nenin 56 të saj se kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Më tej, në kapitullin e objektivave sociale, në nenin 59 paragrafi 1 pika d) dhe dh), kushtetuta përmban një rregullim më të posaçëm për mjedisin, duke parashikuar që *“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”*.

Detyrimet e mësipërme kushtetuese shtjellohen edhe në akte të rëndësishme ligjore ku përfshihet dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Legjislacioni penal i Shqipërisë garanton mbrojtje juridiko-penale ndaj mjedisit, duke marrë përsipër të mbrojtje në mënyrë të drejtpërdrejtë marrëdhëniet juridike të vendosura në Kushtetutë apo në ligje të tjera që lidhen me mjedisin. Normat penale sigurojnë mbrojtje të mjedisit nga të gjitha veprimet apo mosveprimet që mbartin rrezikshmëri shoqërore, të kundërligjshme të kryera me faj dhe që shoqërohen me ardhjen e pasojave të rrezikshme. Në kuadër të mbrojtjes juridiko-penale, parashikohen dënime konkrete penale të cilat zbatohen nga gjykata ndaj autorëve të këtyre veprave penale.

Jo vetëm individët por edhe personat juridikë përgjigjen penalisht për vepra penale të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre. Njësitë e qeverisjes vendore përgjigjen penalisht

vetëm për veprime të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre nga funksionarët e tyre. Përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton atë të personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale. Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligjin Nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë janë parashikuar figura konkrete të veprave penale kundër mjedisit si edhe dënimet përkatëse për autorët e këtyre veprave penale. Veprat penale kundër mjedisit, së bashku me ndryshimet që kanë hyrë në fuqi më datë 08.10.2019, janë parashikuar në Kreun IV të Kodit Penal aktual, si më poshtë:

- **Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës**

Vepra e “ndotjes së ajrit, të ujërave dhe të tokës” mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga personi fizik/juridik, që është i detyruar të marrë masa të caktuara për mbrojtjen e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja.

Në këto raste, kryerja e veprimeve apo mosveprime të kundërligjshme qëndron në ndotjen në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimin e rëndë të kafshëve ose bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materiale në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, ose në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës.

Rastet kur ndotja përbën kundërvajtje administrative janë të përcaktuara në ligjin¹ për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në ligjet e tjera të posaçme që lidhen me të dhe kanë objekt mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës nga ndotja. Dënimi për kundërvajtjet penale është parashikuar me gjobë

1 Neni 69 i ligjit nr.10 431 datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar

ose me burgim deri në dy vjet. Përbëjnë kundërvajtje penale vetëm rastet kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative.

Vepra konsiderohet e kryer **në rrethana cilësuese** kur nga ndotja e ajrit, e kryer nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të sipërpërmendura në kundërshtim me ligjin, kanë ardhur **pasoja të rënda** për jetën e shëndetin e njerëzve, konkretisht, vdekja apo gjymtimi, shëmtimi, ndërprerja e shtatzënisë, ose rrezikimi për jetën në çastin e shkaktimit të tij. Dënimi, në këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- **Neni 201/a - Menaxhimi i mbetjeve**

Vepra “menaxhimi i mbetjeve” mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia dhe konsiston në grumbullimin, transportimin, rikuperimin ose asgjësimin e mbetjeve, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimeve, kujdesin e vend depozitimeve, si dhe veprimet e ndërmarra në shkëlqje të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëme të rënda në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Në këtë mënyrë ligjvënësi ka bërë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore me mosrespektimin e legjislacionit në fuqi që përbëhet nga ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve² dhe aktet e tij plotësuese. Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. Kur kjo vepër konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese, dënimi, për këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- **Neni 201/b - Transportimi i mbetjeve**

Vepra “transportimi i mbetjeve”, që parashikon transportimin e mbetjeve që hyjnë, dalin apo kalojnë transit nga territori i Shqipërisë, në sasi jo të papërfillshme, i kryer në një transportim të vetëm ose në disa transportime në dukje të lidhura me njëri-tjetrin, në shkëlqje

² Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar

të kërkesave të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me gjobë ose burgim deri në pesë vjet. Kjo vepër penale kryhet me dashje ose nga pakujdesia nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura për transportimin pa leje të lëndëve/mbeturinave të ndryshme. Në këto raste, veprimet aktive të kundërligjshme qëndrojnë në transportimin (me mjete të transportit rrugor, hekurudhor, ajror ose edhe ujor) transit (për në një shtet të huaj) të mbeturinave.

Vëmendja edhe në këtë rast duhet drejtuar tek fakti që kjo vepër penale mund të shkaktohet pikërisht duke shkelur elementë të caktuar të ligjit për menaxhimin e integruar të mbetjeve apo ligjet të tjera sektoriale, duke kriminalizuar kështu veprime të caktuara që gjithsesi vlerësohen rast pas rasti nga organet ligj zbatuese.

- **Neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme**

Vepra “aktivitetet e rrezikshme” ka të bëjë me funksionimin e një impianti ku zhvillohet aktivitet i rrezikshëm ose ku ruhen apo përdoren substanca apo preparate të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, të cilat shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë dëme të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Edhe këtu lidhja shkakësore bëhet me ligjin sektorial, por në ndryshim nga nenet e tjera, pasoja që vjen nga shkelja është shumë e qartë dhe ka të bëjë me shkaktimin e dëmeve të rënda jashtë impiantit në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, në kafshë apo në bimë. Kur kjo vepër kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kur kjo vepër konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese, dënimi, për këto raste, është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

- **Neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme**

Në veprën “materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”, prodhimi, përpunimi, trajtimi, përdorimi, ruajtja, magazinimi, transportimi, importimi, eksportimi ose asgjësimi i materialeve bërthamore ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme, në shkelje të kërkesave të legjislacionit përkatës ose të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëm të rëndë në cilësinë e ajrit, cilësinë e tokës ose cilësinë e ujit, apo në kafshë ose në bimë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kjo veprë, kur shkakton ose ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë në shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Kur nga vepra ka ardhur ose ka mundësi të vijë si pasojë vdekja e personit, ajo dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë vjet deri në njëzetë vjet.

Kur kjo veprë kryhet nga pakujdesia, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet.

- **Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër**

Vepra penale “dëmtimit të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”, kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit, për zonat e mbrojtura dhe ligjin për peshkimin. Veprimet e kundërligjshme kanë të bëjnë me vrasjen, shkatërrimi, zotërimin, marrjen e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur mbi një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm në statusin e ruajtjes së specieve. Kundërvajtësi në këto raste dënohet me gjobë ose me burgim.

Këto veprime konsiderohet se i kanë sjellë pasojat e tyre kur shkaktojnë prishjen e ekuilibrit ekologjik, që do të thotë se pasojat ndjehen në faunën dhe florën, duke dëmtuar apo zhdukur specie peshqish, bimësh, kafshësh etj.

- **Neni 202/a - Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër**

Vepra “tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër” parashikon tregtimin e ekzemplarëve të specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër ose pjesëve apo nënprodukteve të tyre, duke shkelur kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e faunës së egër dhe për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë ka ndodhur me një sasi të papërfillshme të këtyre ekzemplarëve dhe ka ndikim të papërfillshëm mbi statusin e ruajtjes së specieve. Kjo veper dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet.

- **Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore**

Vepra e “dëmtimit të habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore” përbëhet nga veprimet që shkelin kërkesat e legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente dhe që shkaktojnë përkeqësim të rëndë të një habitati, që ndodhet brenda një zone të mbrojtur mjedisore dhe dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

Kjo veper mund të kryhet, me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregullat e vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit, të ujërave të deteve, lumenjve, tokës nga ndotja me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera. Në këtë rast, veprimet e kundërligjshme qëndrojnë në hedhjen/shkarkimin, nga anijet që lundrojnë apo të ankoruara në porte; avionët; mjetet e tjera të transportit rrugor apo hekurudhor; uzina, fabrika, ente të ndryshme, individë, etj., të mbeturinave apo lëndëve toksike, radioaktive apo substanca të tjera.

- **Neni 203-Substancat ozonholluese**

Vepra tjetër që ka të bëjë me prodhimin, importimin, eksportimin, nxjerrjen në treg ose përdorimin e substancave ozonholluese, duke shkelur kërkesat e legjislacionit përkatës apo të lejeve dhe autorizimeve të lëshuara nga organet kompetente, dënohet me burgim nga një deri në shtatë vjet.

- **Neni 204- Peshkimi i ndaluar**

Vepra penale e “peshkimit të ndaluar”³, kryhet me dashje ose nga pakujdesia, nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin për peshkimin Nr. 64/2012, i ndryshuar. Veprimet e kundërligjshme qëndrojnë në peshkimin në kohë të ndaluar, kohën e shtimit; peshkimin me mjete të ndaluara, peshkimin në vende të ndaluara, si zonat e mbrojtura etj. Peshkimi i kryer në kohë, me mjete, në vende dhe mënyra të ndaluara nga ligji për peshkimin, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj. Në rastet kur peshkimi kryhet me mjete të rrezikut të përbashkët si eksploziv, lëndë helmuese etj., kjo veprë, konsiderohet e kryer në rrethana cilësuese⁴, dhe kundërvajtësi penal dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

- **Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve**

Vepra e “prerjes së paligjshme të pyjeve” kryhet me dashje nga persona apo subjekte juridike që kanë shkelur rregulla të vendosura me ligj për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjin, Nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe ligji Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”. Veprimet e kundërligjshme aktive kanë të bëjnë me prerjen apo dëmtimin e pyjeve pa lejen e organeve kompetente, prerjen apo dëmtimin e pyjeve në kohë të ndaluar, (në kohën e rigjenerimit, moratorium,) dhe prerjen apo dëmtimin e pyjeve në vende të ndaluara, (në zonat e mbrojtura, vende që rrezikohet erozioni, përmytja, rrëshqitja e tokës, etj.);

3 Neni 204 i Kodit Penal.

4 Neni 204 paragrafi i dytë i Kodit Penal

Rastet kur prerjet apo dëmtimi i pyjeve përbëjnë kundërvajtje administrative janë të përcaktuara nga ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe ligji, Nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” i ndryshuar, si dhe nga aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre. Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

- **Neni 206- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë**

Vepra e prerjes së drurëve dekorativë dhe frutorë kryhet me dashje, nga persona apo subjekte juridike, duke prere drurët dekorative (pisha, bredha, plepa, etj.) që janë mbjelle anës rrugëve në qytete e në vende të tjera; dëmtuar lulishte dhe parqe nëpër qytete, (shkulur lule, futur bagëti në këto lulishte e parqe, etj.); prerë drurët në pemëtore, ullishta e vreshta, pasi është refuzuar më parë leja e prerjes nga organet kompetente.

Dënimi për kundërvajtjen penale, të prerjes së drurëve dekorativë dhe dëmtimin e parqeve dhe lulishteve është me gjobe, ndërsa dënimi për prerjen e pemëtoreve, ullishtave e vreshtave është me burgim deri në tre muaj.

- **Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve**

Vepra e “shkatërrimit me zjarr të pyjeve” dhe të mjedisit pyjor kryhet me dashje dhe me veprime aktive me zjarr që shkaktojnë:

- shkatërrimin apo dëmtimin, me pasoja të rënda materiale të fondit pyjor, të fidanishtes pyjore, të grumbullit pyjor ose të çdo njësie të ngjashme me to. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga pesë deri në tetë vjet.
- ndryshimin e kategorisë dhe destinacionit të tokës. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Kjo vepër, konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, shëndetin ose jetën e njerëzve si dhe kur ka shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo

zonave të mbrojtura. Dënimi për këto raste është me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

- **Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor**

Vepra e “shkatërrimit nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor” kryhet me pakujdesi, duke përdorur mjete me zjarr që shkaktojnë shkatërrimin apo dëmtimin, me pasoja të rënda materiale të fondit pyjor, fidanishtes pyjore, grumbullit pyjor ose të çdo njësie të ngjashme me to. Dënimi për këtë veprim është me burgim nga dy deri në pesë vjet.

Kjo veprë, konsiderohet e kryer në rrethana të cilësuar kur ka shkaktuar pasoja të rënda për pronën, për shëndetin ose jetën e njerëzve si dhe kur ka shkaktuar dëme të rënda dhe të zgjatura në kohë ndaj mjedisit apo zonave të mbrojtura. Dënimi për këto raste është me burgim nga tre deri në tetë vjet.

- **Neni 207- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve**

Vepra e “shkeljes së karantinës së bimëve dhe kafshëve” kryhet, nga subjekte të posaçme, duke vepruar apo mos vepruar në kundërshtim me rregullat e caktuara për karantinën e bimëve dhe shërbimin veterinar. Këto rregulla janë të caktuara me ligjin për shërbimin veterinar, Nr. 10465, datë 29.09.2011, i ndryshuar dhe ligjin për mbrojtjen e bimëve, Nr.105/2016

Për të pasur përgjegjësi penale duhet që nga shkelja e rregullave të karantinës të kenë ardhur pasoja të rënda, në kuptimin që dëmtimi i bimëve nga sëmundjet e rrezikshme, ose ngordhja e kafshëve nga sëmundje ngjitëse të jetë në masë të lartë, ose të rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Kjo veprë penale klasifikohet si kundërvajtje penale dhe është e dënueshme me gjobë.

Tabelë: Përmbledhje e dënimeve për veprat penale kundër mjedisit

Nr.	Vepra penale kundër mjedisit	Masa ndëshkimore në varësi të rrezikshmërisë
1.	Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës	Burg deri në 15 vite
2.	Neni 201/a - Menaxhimi i mbetjeve	Burg deri në 15 vite
3.	Neni 201/b - Transportimi i mbetjeve	Gjobë deri në burgim 5 vite
4.	Neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme	Burg deri në 15 vite
5.	Neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme	Burg deri në 20 vite
6.	Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Gjobë deri burgim 7 vite
7.	Neni 202/a - Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër	Gjobë deri burgim 3 vite
8.	Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore	Gjobë deri burgim 5 vite
9.	Neni 203-Substancat ozonholluese	Burg nga 1 deri në 7 vite
10.	Neni 204- Peshkimi i ndaluar	Gjobë ose burgim deri në 2 vite
11.	Neni 205- Prerja e paligjshme e pyjeve	Gjobë ose burgim deri në 1 vit
12.	Neni 206- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë	Burg deri në 3 muaj

13.	Neni 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	Burg deri në 20 vite
14.	Neni 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor	Burg deri në 8 vite
15.	Neni 207- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve.	Gjobë

II.1. Diskutim i përgjithshëm për veprat penale në fushën e mjedisit

Ajo që bashkon pjesën më të madhe të veprave penale kundër mjedisit, kryesisht ato të shtuara ose ndryshuara në Tetor të vitit 2019, është pikërisht referenca tek legjislacioni sektorial në fuqi, çka do të thotë se Kodi Penal tashmë i shtrin automatikisht pasojat penale në ligjet e tjera të referuara në tabelat që do të shihni në Kreun III të këtij Udhëzuesi. Ligjet sektoriale nga ana e tyre kanë në fakt të parashikuara si ndëshkim masa administrative të mirëpërcaktuara për çdo shkelje, duke i kategorizuar këto masa sipas llojit, rëndësisë së shkeljes dhe shpeshësisë së saj. Masat janë kryesisht të karakterit administrativ (pezullim dhe/ose pushim aktiviteti) ose monetar (gjoba të ndryshme për shkeljet e kryera apo zhdëmtim, rikuperim i pasojave negative), por kur shfaqen pasojat e përcaktuara në secilën vepër të Kodit Penal, transformohen automatikisht në krime ose kundërvajtje penale mjedisore dhe rrjedhimisht kthehen në të dënueshme edhe burgim.

Ajo që mbetet problematike dhe që as ky udhëzues nuk arrin ta shterojë plotësisht është mjegullia ligjore e kompetencave që i janë dhënë NjQV-ve nga pikëpamja administrative por edhe vete identifikimi i atyre veprimeve apo mosveprimeve që mund të bien nën suazën e krimit mjedisor. Sistemi i mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri, që përbëhet pikërisht nga lidhja midis ligjeve administrative dhe dispozitave të kodit penal, nuk përmban një dallim të qartë se çfarë përbën kundërvajtje administrative dhe çfarë përbën vepër penale në dritën e mbrojtjes së

mjedisit. Nëse i referohemi për shembull neneve të shtuara rishtazi gjatë muajit Tetor 2019 në Kodin Penal, konstatojmë një diapazon shumë të zgjeruar të anës objektive të figurave të veprave penale përkatëse. Kjo do të thotë që mund të ketë vështirësi gjatë zbatimit në praktikë të punës së organeve të drejtësisë dhe për respektimin e parimit të njohur të drejtës penale që asnjë të mos mbetet pa u dënuar dhe asnjë të pafajshmi të mos i privohet liria. Rrjedhimisht, nuk ofrohet dallimi ndërmjet kompetencave administrative dhe atyre penale dhe kjo lë hapësirë për zbatim të ndryshëm në situata të ngjashme, që në fund të fundit do të trajtohet ekskluzivisht në varësi të bindjes së brendshme të gjyqtarit.

III. Kompetencat funksionale dhe përgjegjësitë konkrete të bashkive dhe organeve të tyre të varësisë

Qëllimi Qëllimi i këtij kapitulli është t’u ofrojë zyrtarëve vendorë bazën e plotë ligjore të veprimtarisë së tyre në raport me krimin mjedisor me qëllim krahasimin e pajtueshmërisë së këtyre ligjeve me parashikimet e shpjeguara në Kreun II, në mënyrë që “lufta” kundër krimit mjedisor të unifikohet dhe eliminimi i pasojave të jetë me efektiv. Për këtë arsye, ky udhëzues ka përdorur si referencë pikërisht veprat penale në fushën e mjedisit, siç janë trajtuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për të evidentuar cilat janë kompetencat e autoriteteve vendorë dhe funksionarëve të tyre përgjegjës për krimin mjedisor, për të siguruar atë që quhet pajtueshmëri me detyrimet përkatëse ligjore. Kompetencat vendorë ose, më saktë, ajo që mund të bëjnë dhe kanë detyrë të bëjnë autoritetet vendorë në raport me veprat penale mjedisore, janë paraqitur duke evidentuar atributet që i janë dhënë autoriteteve vendorë në ligjet e posaçme në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Veç Kodit Penal dhe parashikimeve të tij, ligjet e posaçme të shqyrtuara për të evidentuar se cilat janë ato kompetenca të pushtetit vendor që sigurojnë pajtueshmërinë ligjore me detyrimet që burojnë nga ligji, janë renditur në katër tabelat e mëposhtme. Këto tabela përmbajnë bazën ligjore kryesore të funksioneve dhe kompetencave të dhëna NjQV-ve nga ligjet sektoriale, ndërkohë që baza e plotë ligjore e përbërë nga aktet parësore dhe dytësore gjendet në tabelën e **Shtojcës 1** të këtij Udhëzuesi.

Ndarja ndërmjet dy niveleve të qeverisjes së përgjegjësisive për administrimin, rregullimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes vendore në raport me parandalimin, evidentimin dhe ndjekjen e krimit mjedisor është e strukturuar në këtë Udhëzues duke bërë një ndarje funksionale lidhur me përgjegjësitë e bashkive për veprim, monitorim apo kontroll, duke qenë se inspektimi nga pikëpamja ligjore i takon thujasë ekskluzivisht organeve të pushtetit qendror.

Struktura e administrimit apo përgjegjësisë së funksioneve është hartuar mbi bazën e attributeve të dhëna në legjisllacionin sektorial dhe të renditur sipas përkufizimeve, në radhë të parë të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe më tej sipas përkufizimeve të legjisllacionit sektorial përkatës.

Renditja e funksioneve është analizuar duke evidentuar cilat janë përgjegjësitë që i ngarkohen njësisive të vetëqeverisjes vendore, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me shfaqjen potenciale të ngjarjeve të krimit mjedisor. Ky udhëzues është hartuar duke marrë të mirëqenë situatën ligjore siç është aktualisht dhe nuk merr përsipër të analizojë mungesa, mbivendosje dhe mospërputhje ligjore që lidhen me institucionet e qeverisjes qendrore dhe që mundet ose jo të ndikojnë në veprimtarinë e bashkive për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Tabelat e mëposhtme përmbajnë në këtë mënyrë pikërisht listën e atyre ligjeve, shkelja e të cilëve apo mosrespektimi i kushteve të të cilëve, mund të sjellin shkaktimin e veprave penale kundër mjedisit. Duke qenë se këto ligje përcaktojnë funksione konkrete të NjQV-ve, vëmendja duhet të jetë e shtuar sepse në kryerjen e funksioneve të veta, NjQV-të mund të gjenden përpara krimeve mjedisore, identifikimin e të cilëve mund ta bëjnë lehtësisht duke pasur parasysh kush janë detyrimet ligjore që duhen respektuar sipas tabelave më poshtë, ndërkohë që ofrohet shpjegim të hollësishëm se çfarë përbën ose jo krim mjedisor referuar situatave të shpjeguara në Kreun II të këtij Udhëzuesi.

Tabela Nr. 1

Kompetencat e dhëna për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NjQV) nga Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në fushën e mbrojtjes së mjedisit në nivel vendor

Referenca ligjore	Përshkrimi i dispozitës
Neni 9 - Të drejtat dhe përgjegjësitë	Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë struktura administrative për kryerjen e funksioneve dhe ushtrimin e kompetencave të tyre, sipas ligjeve në fuqi.
Pikat 2 dhe 10 të nenit 23 - Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike	Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: (i) mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; (ii) Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
Neni 26 - Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit	<p>Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja. 2. Sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen nga ndotja akustike. 3. Zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

<p>Pikat 5 dhe 6 Nenit 27</p> <ul style="list-style-type: none"> - Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit 	<p>Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi. - Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjislacionit në fuqi.
--	--

Ndërthurja me veprat penale

Për sigurimin e masave për mbrojtjen e mjedisit, NJQV-së nuk i jepen kompetenca për matje, kontroll dhe monitorim të treguesve përkatës, por secila Bashki mund t'i ushtrojë këto funksione bazuar në nene të tjera të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht:

- Për cilësinë e ajrit; në funksionin e transportit publik vendor dhe parqeve, lulishteve dhe hapësirave të gjelbra publike (neni 23 pikat 6 dhe 9);
- Për cilësinë e ujit të pijshëm; në funksionin e prodhimit, trajtimit, transmetimit dhe furnizimit me ujë të pijshëm (neni 23 pika 1);
- Për ujërat e ndotura; në funksionin e mbledhjes, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura (neni 23 pika 2);
- Për ujërat e ujitjes dhe kullimit; në funksionin e administrimit të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (neni 27 pika 1);
- Për mbrojtjen e cilësisë së tokës; në funksionin e administrimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore e të kategorive të tjera resurseve, si dhe mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit (neni 27);

Sipas nenit 23 të ligjit për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj, NjQV-ja siguron masat për mbrojtjen e mjedisit, veçanërisht për cilësinë e tokës, si pjesë e funksionit të planifikimit, zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike.

Tabela Nr. 2	
Kompetencat e dhëna për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi dhe mbrojtjes së tokës nga ndotja	
Referenca ligjore	Përshkrimi i dispozitës
Ligji Nr. 10431, datë 9.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar	
Neni 22	<p>Planet vendore të veprimit për mjedisin</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Autoritetet e qeverisjes vendore përgatisin plane veprimi, vendore, për mjedisin në mënyrë periodike, në përputhje me strategjitë dhe planet e referuara në nenin 21 të këtij ligji. 2. Planet e veprimit, vendore, për mjedisin rishikohen dhe përditësohen në mënyrë të rregullt, sipas nevojave. 3. Këshilli i autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse miraton planet e referuara në pikën 1 të këtij neni. 4. Kryetarët e njërive të qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raportojnë në këshillin e qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.
Ligj Nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar	
Neni 21, pika 12	<p>Përgjegjësitë për menaxhimin e integruar të mbetjeve</p> <p>Kryetarët e njërive të qeverisjes vendore janë përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e mbetjeve që krijohen brenda territorit të tyre administrativ, në përputhje me kërkesat e këtij ligji.</p>

Legjislacioni për mbrojtjen e tokës nga ndotja

- Ligji Nr. 9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8752, dt. 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin e mbrojtjes së tokës” i ndryshuar;
- VKM Nr. 80, datë 28.01.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”, e ndryshuar;
- VKM Nr. 121, datë 17.02.2011, “Për mënyrën e ushtrimit të funksioneve nga Drejtoritë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qarqe dhe Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës në bashki.

Autoritetet shtetërore dhe strukturat pranë tyre, të cilat kane detyrime dhe përgjegjësi për mbrojtjen e tokës bujqësore janë:

- a) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- b) Komiteti Shtetëror i Mbrojtjes së Tokës (KSHMT);
- c) Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës
- ç) Këshilli i qarkut;
- d) Kryetari i këshillit të qarkut;
- dh) Komisioni i Mbrojtjes së Tokës (KMT) në qark;
- e) Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës (IMT) në qark
- ë) Këshilli i bashkisë;
- f) Kryetari i bashkisë.

Autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e tokës bujqësore, për të gjithë territorin në juridiksionin e tij, është këshilli i bashkisë. Kryetari i bashkisë ka për detyrë:

- a) të drejtojnë dhe të kontrollojnë punën e drejtuesve të nënndarjeve të bashkisë dhe të administratorëve të caktuar në nënndarjet e bashkisë për veprimtaritë për mbrojtjen e tokës bujqësore;
- b) të raportojë në KMT-në e qarkut për gjendjen në territorin e tij;
- c) të zbatojnë vendimet dhe urdhëresat e këshillit të qarkut dhe KMT-së, që kanë si objekt territorin e komunës ose bashkisë.

Pranë çdo bashkie funksionon ZMMT-ja e cila ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) Përgjigjet për menaxhimin dhe mbrojtjen e tokës bujqësore, në pronësi shtetërore dhe në pronësi private, si dhe të kategorive të resurseve të tjera,.
- b) Mban dhe ruan me inventarizim dokumentacionin kadastral ekzistues, që ka për objekt kategoritë e resurseve në juridiksion të saj. ;
- c) të zbatojnë vendimet dhe urdhëresat e këshillit të qarkut dhe KMT-së, që kanë si objekt territorin e komunës ose bashkisë.
- d) Bazuar në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe dokumentacionin e ri kadastral, që grumbullohet dhe sistemohet, plotëson “Regjistrin e tokës bujqësore dhe të disa kategorive të tjera të resurseve”.

<ul style="list-style-type: none"> • Ligj Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar • Ligj Nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, ndryshuar 	<p>Autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit janë Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Kryetari i bashkisë.</p> <p>Autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit në nivel vendor janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Këshilli bashkiak; b) Kryetari i bashkisë. <p>Kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit kryhet nga inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore përkatëse dhe/ose Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.</p>
---	---

Ndërthurja me veprat penale

Në kuadër të administrimit dhe mbrojtjes së tokave bujqësore dhe të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, funksion ky i dhënë NjQV-ve sipas nenit 27, pika 2, e ligjit për vetëqeverisjen vendore, ZMMT-të në bashki kanë detyra organizative, monitoruese dhe menaxhuese, por nuk kanë funksione inspektuese dhe sanksionuese të veprimtarive të caktuara. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës në këshillin e qarkut bën kallëzim penal në organet e drejtësisë për shkatërrim prone në çdo rast kur vëren shkatërrim të tokës bujqësore, ndryshim të kundërligjshëm të kategorizimit të tokës bujqësore, zhvillimit të veprimtarisë ndërtimore në tokat bujqësore, ngritje dhe shfrytëzim karriere për materiale dhe lëndë të tjera inerte përgjatë rrjedhës së lumenjve etj., si dhe çdo rast tjetër të ngjashëm, që strukturat e mbrojtjes së tokës në bashki dhe në qark e vlerësojnë se ka shkaktuar dëmtime të rënda të tokës bujqësore.

Për sa i takon mbledhjes, largimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta shtëpiake, duhet t'i referohemi edhe ligjit Nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. NjQV-të kanë kompetenca të caktuara në këtë ligj, të cilat janë referuar dhe në tabelë, që mund t'i japin mundësinë cilitdo punonjës të bashkive të marrin dijeni apo vendosën përballë krimeve mjedisore të përcaktuara në nenin 201/a -

Menaxhimi i mbetjeve, neni 201/b - Transportimi i mbetjeve, neni 201/c - Aktivitetet e rrezikshme dhe neni 201/ç - Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme, etj., të Kodit Penal.

Në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, NjQV-të kanë disa kompetenca të drejtëpërdrejta që mund të lidhen me seksionin e veprave penale që mund të shkaktohen nga personat juridikë dhe fizikë që kryejnë aktivitete ndërtimore. Gjatë këtyre aktiviteteve, NjQV-të mund të konstatojnë krime mjedisore që lidhen me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit (p.sh. Neni 201- Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës; Neni 201/a - Menaxhimi i mbetjeve, Neni 202- Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër, Neni 202/b - Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore, Neni 203-Substancat ozonholluese etj.) Vetë Kryetari i Bashkisë jep leje zhvillimi dhe leje ndërtimi apo pezullon leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, ndërkohë që NjQV-ja siguron një nivel bazë të përshtatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre dhe vlerëson respektimin e kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh si dhe vlerëson respektimin e kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh.

Nga ana tjetër, nëpërmjet inspektimeve, inspektoratet e mbrojtjes së territorit të njërive vendore përkatëse vlerësojnë respektimin e kërkesave ligjore për punimet e kryera mbi bazën e deklaratës paraprake për kryerje punimesh dhe vendosin gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në këtë mënyrë sfera e veprimit në konstatimin potencial të një krimi mjedisor në këto raste është shumë e gjerë në ndryshim nga kompetenca të tjera që pamë më sipër që janë të karakterit monitorues.

Tabela Nr. 3	
Kompetencat e dhëna për njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJQV) në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së ujërave dhe ajrit	
Referenca ligjore	Përshkrimi i dispozitës
Ligji Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” i ndryshuar;	
Neni 31 - Cilësia e ujit të pijshëm, pika 3	Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion tjetër, publik a privat, që kanë sistemin e tyre të furnizimit me ujë, detyrohen të marrin masa për një kontroll të rregullt të cilësisë së ujit të furnizuar.
Neni 72 - Kompetencat e organeve të menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, pika 1	Organet e administrimit të burimeve ujore, në bashkëpunim me inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit dhe organet e qeverisjes vendore, kanë të drejtë të mbikëqyrin e të detyrojnë subjektet, persona fizikë apo juridikë, të instalojnë pajisje për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit në tokë private, si dhe të servituteve që nevojiten për hyrjen në instalime të tilla, për punën përgatitore dhe për ndërtimin.
Neni 95 - Organet përgjegjëse për zbatimin e ligjit, pika 1	Organet e administrimit të burimeve ujore, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, për bujqësinë, strukturat dhe organet e emergjencave civile, të rregullimit e planifikimit të territorit janë përgjegjëse për marrjen e masave dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003 Për trajtimin mjedisor të ujerave të ndotura, i ndryshuar	
Neni 4, pika 2 - Detyrat e organeve shtetërore	Organet shtetërore, qendrore e vendore, secili në linjën e vet, bashkëpunojnë me Ministrinë e Mjedisit për: <ul style="list-style-type: none"> a. kontrollin e vazhdueshëm të veprimtarive që shkaktojnë ndotje të ujerave, si dhe të subjekteve që angazhohen në trajtimin dhe pastrimin e tyre
Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”	
Neni 4, pika 3 Autoritetet kompetente	Njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për masat që duhen marrë në kuadër të legjislacionit të tyre të posaçëm, të cilat çojnë në ruajtjen ose përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Neni 7, pika 8, 9, 11 dhe 12 - Planet e cilësisë së ajrit	Plani i aglomeratit dhe plani i zonës, kur zona është pjesë e një aglomerati ose e një bashkie, përgatitet nga bashkia përkatëse dhe miratohet nga këshilli bashkiak.
Neni 8 - Planet e veprimit afatshkurtër, pikat 1,2,3,4 dhe 7	Autoritetet e përmendura në pikat 8, 9 dhe 10, të nenit 7, të këtij ligji, pra përfshirë Bashkitë duhet të përgatisin dhe të zbatojnë planin e veprimit afatshkurtër në çdo rast kur në ndonjë zonë ose aglomerat ekziston rreziku që nivelet e ndotësve të kapërcejnë një apo më shumë nga pragjet e alarmit, të përcaktuar sipas vendimit të referuar në nenin 5 të këtij ligji.
Ligji Nr. 9103, Datë 10.07.2013 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare” (i ndryshuar)	
Neni 5 Detyrat e organeve shtetërore	<p>Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me organet shtetërore përkatëse, qendrore e vendore dhe me autoritetet e ujit, secili në linjën e vet, organizojnë punën për mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare, kontrollojnë zbatimin e kërkesave të këtij ligji dhe marrin pjesë:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të liqeneve ndërkufitare; b. në hartimin dhe zbatimin e programeve të veçanta të monitorimit; c. në hartimin dhe zbatimin e planeve vendore për rehabilitimin e pjesëve të ndotura e të dëmtuara të liqeneve ndërkufitare; d. në krijimin e kuadrit ligjor bashkëkohor për administrimin dhe mbrojtjen mjedisore të tyre; e. në sigurimin dhe përdorimin e frytshëm të mjeteve të nevojshme financiare; f. në kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të liqeneve ndërkufitare dhe të faunës e florës së tyre.
Neni 8 Administrata e liqeneve, pika 1	Për administrimin dhe mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare si zona të mbrojtura, krijohen administratat e liqeneve, në varësi të qarqeve përkatëse.

Neni 21- Kontrolli, pika 3	Kontrolli ushtrohet nga Autoriteti i Ujit, nga administrata e liqenit, nga Inspektorati i Mjedisit në bashkëpunim me Inspektoratin e Peshkimit, me Policinë e Ndërtimit, me Policinë e Shërbimit Pyjor dhe me Policinë Bashkiake, si dhe nga organet që kanë licencuar veprimtaritë, te cilët ushtrojnë kompetenca sipas ligjeve, qe i kane krijuar këto organe.
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”	
Neni 8 - Organet e qeverisjes vendore	Organet e qeverisjes vendore, brenda juridiksionit të tyre: <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtojnë hartimin dhe zbatimin e planeve vendore të veprimit për zhurmën, të cilat miratohen nga këshillat e bashkive. 2. Drejtojnë procesin e hartëzimit të zhurmës. 3. Shpallin zona të qeta, në një mjedis të banuar apo në një mjedis të hapur, si dhe vendosin kufizime të tjera për zhurmën, në përputhje me planin vendor të veprimit. 4. Kërkojnë nga personat fizikë e juridikë që ushtrojnë veprimtari apo përdorin impiante dhe instalime që lëshojnë zhurmë, marrjen e masave parandaluese për respektimin e vlerës kufi të zhurmës. 5. U kërkojnë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontroll, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo të mbyllin veprimtari, që nuk respektojnë dispozitat e këtij ligji.
Neni 15- Shfrytëzimi i ndërtesave, pika 1	Organi i qeverisjes vendore, që jep lejen e shfrytëzimit të objektit, me përjashtim të banesave vetjake, verifikon edhe zbatimin e kërkesave të pikës 1 të nenit 14 (projektimi i ndërtesave) të këtij ligji.
Neni 29 - Organet e kontrollit	Kontrolli i zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe i akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, kryhet nga Inspektorati i Mjedisit, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës, struktura përgjegjëse për kontrollin e mjedisit të bashkisë dhe Inspektorati i Kontrollit të Automjeteve.

<p>Neni 30 Vendimi i kontrollit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pas kryerjes së kontrollit, vendimi merret në përputhje me ligjin për inspektimin nga inspektori ose zyrtari i ngarkuar me këtë funksion i strukturës përgjegjëse të pushtetit vendor që bën kontrollin. Në rast të konstatimit të shkeljeve, inspektori ose zyrtari cakton masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkon me gjobë kundërvajtjet administrative dhe, sipas rastit, vendos mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë. 2. Rezultatet dhe vendimi i kontrollit u njoftohen subjektit të kontrolluar dhe organit të qeverisjes vendore, në territorin e të cilit ndodhet veprimtaria e kontrolluar. Një përmbledhje e vendimit të kontrollit vihet në dispozicion të publikut për 1 muaj, duke u depozituar në organin e qeverisjes vendore përkatëse. 3. Sipas nevojave të rastit, inspektori ose struktura përgjegjëse e pushtetit vendor, marrin masa urgjente në përputhje me ligjin për inspektimin.”.
-------------------------------------	--

Ndërthurja me veprat penale

Bashkitë kanë funksione që sanksionohen nga ligji për vetëqeverisjen vendore të tilla si mbrojtjen nga ndotja e ajrit, ujit dhe ajo akustike. Megjithatë, këto funksione në gjithë sferën e tyre, pra në kuptimin e inspektimit dhe kontrollit, janë nën autoritetin e Inspektoratit Qendror. Bashkitë nuk kanë kompetenca rregullatore (d.m.th. leje, licenca) dhe përgjegjësia për të përpunuar plane të veprimit mjedisor shihet thjesht si formalitet. Kompetencat administrative bashkiake janë disi të kufizuara e megjithatë ekziston mundësia që në kryerjen e detyrave të saj, Bashkia nëpërmjet Policisë Bashkiake të vendosë sanksione minimale për shkelje të ndryshme, kryesisht në fushën e ndotjes akustike. Bashkia mund t'i kërkojë organeve të kontrollit të ushtrojnë kontrole, të bëjnë matje dhe të pezullojnë apo mbyllin një veprimtari. Po ashtu Bashkia merr vendimin e kontrollit duke caktuar masat dhe detyrat për rregullimin e gjendjes, ndëshkimin me gjobë, kundërvajtjet administrative dhe mbylljen, ndalimin apo ndërprerjen e plotë ose të pjesshme të veprimtarisë. Edhe gjatë kësaj veprimtarie, NjQV-të mund

të hasin krimet mjedisore të parashikuara nga Neni 201, 202 dhe 202/b etj., të Kodit Penal.

Tabela Nr. 4	
Kompetencat e dhëna për njësitë e vetëqeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së natyrës dhe pyjeve	
Referenca ligjore	Përshkrimi i dispozitës
Ligji Nr. 9385, datë 4.05.2005, “Për pyjet dhe policinë pyjore” i ndryshuar;	
Neni 7 - Organizimi i shërbimit pyjor, pika 3/1	Bashkia ngre strukturën e saj për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor dhe kullosor brenda kufijve territorialë administrativë, me personel inxhiniero-teknik me arsim pyjor.
Neni 9 - Strukturat e shërbimit pyjor, pika 2	Strukturat përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë bashkive janë organi administrativ i shërbimit pyjor dhe përgjigjen për sigurimin e mbrojtjes, për qeverisjen e qëndrueshme dhe kontrollin e miradministrimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit administrativ të bashkisë.
Neni 20 - Ruajtja e fondit pyjor kombëtar, pikat 2, 3, 4, 5, 7, 9	Ruajtja e pyjeve dhe e mjedisit pyjor nga ndotja dhe dëmtimi me lëndë të gazta, të lëngëta, të ngurta, radioaktive, lëndë dhe mbetje të rrezikshme, që krijohen ose shkarkohen nga objekte a veprimtari industriale, bujqësore, komunale, tregtare, shoqërore e kulturore, ushtarake, të transportit ose nga veprimtari të tjera, që cenojnë ekuilibrin e sistemeve ekologjike, natyrore ose dëmtojnë të mirat materiale dhe vlerat kulturore e historike, është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, të pushtetit vendor dhe për personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj. Personat fizikë dhe juridikë, që kanë në pronësi, në administrim ose në përdorim pyje, grumbuj drurësh ose dru pyjorë, brenda ose jashtë fondit pyjor kombëtar, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e tyre.
Neni 37 - Përgjegjësitë për moszbatimin e ligjit, pika 4	Punonjësit e tjerë të shërbimit pyjor, punonjësit e pushtetit vendor që mbulojnë pyjet dhe pronarët privatë, në rastet kur konstatojnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, janë të detyruar të njoftojnë menjëherë Policinë Pyjore për të kryer procedurat e nevojshme.

Ligji Nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullor”, i ndryshuar	
Neni 26 - Kompetencat e bashkive dhe të pronarëve privatë	<p>Bashkitë janë pronarë të kullotave shtetërore që gjenden brenda territorit administrativ të tyre. Bashkitë dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe, kanë këto kompetenca:</p> <p>a) ruajnë, administrojnë dhe përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij;</p> <p>b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet;</p> <p>c) marrin masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre;</p> <p>ç) raportojnë në ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhënat që u kërkojnë për inventarizimin dhe regjistrimin në regjistrin e fondit kullor të kullotave dhe livadheve, në përputhje me formularët tip;</p> <p>d) njoftojnë ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet për infeksionet dhe dëmtuesit, që shfaqen në kullota e livadhe.”.</p>
Neni 29 - Organet e kontrollit	Kontrolli për zbatimin e këtij ligji bëhet nga Policia Pyjore dhe strukturat menaxhuese të kullotave e livadheve në nivel qendror dhe vendor.
Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar;	
Neni 40 - Organet e kontrollit	<p>Ngarkohen organet e kontrollit të qeverisjes vendore për kontrollin e mbrojtjes së faunës së egër, brenda vijës së verdhë të vendbanimeve dhe në habitatet në pronësi apo në përdorim të komunave e bashkive.</p> <p>Për të rritur efektshmërinë e kontroleve, Policia Pyjore, Inspektorati i Peshkimit dhe organet e kontrollit të qeverisjes vendore bashkëpunojnë me institucionin e veterinarisë dhe inspektorët e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit të qarqeve përkatëse.</p> <p>Vepriktaria kontrolluese, sipas këtij neni, ushtrohet në përputhje me këtë ligj, ligjin Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera në fuqi.</p>

Neni 42 - Përgjegjësitë për shkeljen e dispozitave të ligjit	<p>Shkeljet e dispozitave të këtij ligji sjellin, sipas rastit, përgjegjësi administrative dhe penale.</p> <p>Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 43 të këtij ligji, e kanë inspektorët e Policisë Pyjore, të Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit dhe organet e kontrollit të qeverisjeve vendore.</p>
--	--

Ndërthurja me veprat penale

Në funksionin e administrimit të fondit pyjor dhe kullësor publik, NjQV-të kanë kompetenca më të zgjeruara duke qenë se është bërë decentralizim tërësor i funksionit të pyjeve dhe kullotave vendore, shërbimi pyjor apo strukturat e pyjeve dhe kullotave në Bashki është ristrukturuar dhe është decentralizuar tek bashkitë edhe pse në nuk ka në asnjë tagër për marrjen e masave administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e kundërvajtjeve në sektorin e pyjeve dhe kullotave.

NjQV-të madje kanë edhe të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 43 të ligjit Nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, i ndryshuar.

Strukturat e pyjeve dhe kullotave janë të detyruara në rastin e konstatimit të kundërvajtjeve të njoftojnë policinë pyjore për vendosjen e masave administrative (neni 37 i ligjit Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar). Rrjedhimisht, gjatë kësaj veprimtarie, këto struktura mund të hasen në krimet mjedisore të parashikuara në nenin 205 - Prerja e paligjshme e pyjeve, nenin 206 - Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë, nenin 206/a - Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe nenin 206/b - Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor,

III.1. Marrja dijani dhe kallëzimi i fakteve penale/krimeve që ndotin apo dëmtojnë mjedisin.

Pavarësisht se NjQV-të nuk kanë funksione konkrete inspektuese, gjatë veprimtarisë së tyre monitoruese apo kontrolluese atyre u lind detyrimi për të konstatuar dhe raportuar krimet mjedisore. Kur gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve apo të shërbimit të tyre, punonjësit e bashkisë, marrin dijani për raste dhe fakte të ndotjes apo dëmtimit të mjedisit (ajrit, ujit, tokës, pyjeve, faunës e florës), duhet të njoftojnë Inspektoratin në juridiksionin e njësive të qeverisjes vendore, në bazë të ligjit Nr. 10 433 datë 16.06.2011 “Për inspektoratin në Republikën e Shqipërisë” si dhe Policinë e Shtetit, në bazë të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, si subjekte që ligji i ngarkon me detyrat për parandalimin, zbulimin, inspektimin, në përputhje me legjislacionin administrativ, kundërvajtësit dhe personat fizikë apo subjektet juridike përgjegjës; dhe hetimin, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre.

- Si vihet në dijani prokuroria ose policia për kryerjen e një krimi mjedisor?

Punonjësit e bashkisë, në cilësinë e nëpunësit publik, kanë detyrimin që të bëjnë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ose Policinë Gjyqësore (pranë Policisë së Shtetit ose në Prokurori). Ky detyrim buron nga neni 281 i Kodit të Procedurës Penale. Në Kodin e Procedurës Penale thuhet se nëpunësit publikë, të cilët gjatë ushtrimit të detyrave ose për shkak të funksioneve të shërbimit të tyre, marrin dijani për një vepër penale që ndiqet kryesisht, detyrohen të bëjnë kallëzim me shkrim edhe në rastet kur nuk është individualizuar personi që dyshohet të ketë kryer vepër penale.

- Çfarë ndodh pas kryerjes së kallëzimit? A do të thotë kjo që ndjekja penale fillon automatikisht?

Prokurori i caktuar për çështjen, vlerëson rast pas rasti në lidhje me kallëzimin e depozituar. Ai mund të vendosë mosfillimin e çështjes

penale. Prokurori mund të vendosë gjithashtu dërgimin e çështjes për gjykim.

- Çfarë mjete ka NjQV-ja në rast se Prokurori nuk e fillon ndjekjen penale apo e pushon atë?


NjQV njoftohet për këtë vendim të prokurorit dhe automatikisht ka të drejtë të ankohet në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit. Nëse gjykata e refuzon ankimin, ata kanë të drejtë që brenda 10 ditëve të ankohen në gjykatën e Apelit.

IV. Procedurat Standarde Operacionale (PSO) të tre sektorëve të posaçëm

Sipas sektorëve, PSO-të kanë si qëllim të lehtësojnë, parandalojnë, gjurmojnë dhe të hetojnë krimet mjedisore në Shqipëri, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe procedurat që lidhen me shkeljet në fushën e mjedisit. Më konkretisht, tre sektorët në mënyrë të grupuar përfshijnë kontrollin e **ndotjes, mbrojtjen e natyrës dhe pyjet si dhe kontrollin e mbetjeve.**

Sipas sektorëve, PSO-të ofrojnë hollësi rreth aspekteve të veçanta të këtyre tre sektorëve dhe trajtojnë çështje që kanë të bëjnë me kontrollin e ndotjes, mbrojtjen e natyrës dhe pyjeve dhe kontrollin e mbetjeve në kontekstin institucional të veprimtarisë së autoriteteve vendore dhe bashkëpunimit të tyre me institucione të tjera në nivel qendror, të tilla si inspektoratet, Ministria përgjegjëse për mjedisin dhe organet e varësisë

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund t'i vënë në zbatim këto PSO duke mbrojtur mjedisin në mënyrë të ligjshme dhe përpjesëtimore. Kjo përfshin ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme për të siguruar pajtueshmërinë e qytetarëve dhe bizneseve me detyrimet ligjore përkatëse. Sigurimi i pajtueshmërisë është një përkufizim që përfshin tërë zinxhirin e aktiviteteve të ndërmarra për të garantuar këtë qëllim. Zinxhiri i sigurimit të përputhshmërisë mund të ndërtohet sipas skemës së mëposhtme:





Autor: Silver Balla, përgatitur në kuadër të Konkursit Studentor të Artit Pamor
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2018

PSO 1: Mbrojtja e ujit, ajrit dhe tokës nga ndotja

Hapi 1 – Marrja e Informacionit

Informacioni mund të merret ose nga qytetarët ose nga secili punonjës i bashkisë i vendosur në terren pavarësisht detyrës së tij funksionale. Secili ka detyrimin të raportojë, të paktën eprorit të drejtpërdrejtë nëse konstaton një ngjarje jo miqësore ndaj mjedisit.

Hapi 2 – Ushtrimi i monitorimit dhe/ose kontrollit

Kontrolli mund të jetë periodik ose në bazë njoftimi. Kontrolli periodik kryhet nga të gjitha strukturat kontrolluese të bashkisë sipas një plani operacional të hartuar nga vetë Bashkia.

Pas marrjes së informacionit, struktura kontrolluese e Bashkisë, së bashku me inspektorët e Bashkisë (p.sh. Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake apo struktura të tjera të bashkisë të ngarkuara me kontrollin e ndotjes së sipërfaqeve ujore, tokës apo ajrit), ushtrojnë kontrollin në terren.

Hapi 3- Mbledhja e provave

Ekzistenca e krimit mjedisor të ndotjes së tokës, ujit apo ajrit mund të identifikohet në bazë të informacionit fillestar të siguruar nga vetë qytetarët, informacionet e grumbulluara nga punonjësit e NjQV-ve, ankesës konkrete apo kallëzimeve nga qytetarë apo institucione të ndryshme. Gjetjet ose konstatimet fillestare mund të mblidhen dhe administrohen nga autoritetet vendore nëpërmjet një sistemi të brendshëm grumbullimi ose mbajtjeje të provave.

Ekzistenca e një krimi mjedisor gjithashtu mund të përcaktohet bazuar në:

- konstatimet fillestare gjatë rasteve konkrete;
- akuzat e ngritura nga qytetarë apo institucione;
- konstatimet fillestare të marra përmes mediave; ose

- konstatimeve fillestare të marra përmes informacioneve që qarkullojnë publikisht por që duhen konstatuar në vend.

Informacioni që qarkullon publikisht, zakonisht u referohet lajmeve për të cilat punonjësit e bashkive marrin dijeni në biseda rastësore apo në kanale zyrtare për emra konkret ndotësish ose ndotje në vende të caktuar. Përveç konstatimit në vend, institucioni menjëherë informon Inspektoratin që mbulon fushën e mjedisit dhe sipas rastit vlerëson nëse duhet të kallëzojë veprën apo ta lërë këtë detyrim për inspektorët.

Pas konstatimeve fillestare në lidhje me krimin e kryer mjedisor, faza tjetër është verifikimi i informacionit dhe mbledhja e provave në lidhje me veprën e identifikuar dhe shkelësin e mundshëm. Është e rëndësishme që secili zyrtar publik t'i përgjigjet ose të kërkojë përgjigjen e këtyre pyetjeve kryesore: Çfarë ka ndodhur? Kush mund të jetë shkaktari? Ku ndodhi ngjarja? Kur ndodhi? Si ndodhi? Pse ndodhi? Kush u cënua? Cili është autoriteti përgjegjës?

Pyetjet e mëposhtme janë pjesë e një mini metodologjie që mund të përdoret nga zyrtarët vendorë për vërtetimin dhe potencialisht zgjidhjen e rasteve të krimit mjedisor:

- A ka ndotje të mjedisit? Çfarë forme ka ndotja?
- Në cilën zonë është shfaqur ndotja dhe sa është përhapur?
- Cila është vendndodhja e saktë e burimit të drejtpërdrejtë të ndotjes?
- Cili është lloji, shtrirja dhe ashpërsia e pasojave të dëmshme?
- Çfarë e ka shkaktuar ndotjen?
- Cilat akte ligjore të mbrojtjes së mjedisit janë shkelur?
- A ekziston rrezik potencial apo konkret?
- Çfarë aktiviteteve shkaktuan ndotjen?

- Çfarë forme mund të marrë ndotja në të ardhmen e afërt apo të largët?
- A ka aktiviteti (ose mosveprimi) karakteristikat e një krimi mjedisor ose të një vepre penale sipas shpjegimeve të Kreut II të këtij udhëzuesi?
- Kush është shkaktari i krimit mjedisor?
- Kur dhe ku u zhvillua aktiviteti/mosveprimi?
- Sa do të zgjasë ndotja?
- A ka vepruar shkaktari i krimit me paramendim apo nga pakujdesia?
- Cili ishte motivi?
- A ka rrethana rënduese dhe/ose lehtësuese?
- A ishte kryer vepra penale nga një individ i vetëm apo i ndihmuar nga një grup bashkëpunëtorësh?
- Cilat masa të posaçme duhet të merren për të parandaluar një ndotje të ngjashme në të ardhmen?
- A janë marrë masa për të trajtuar veprën mjedisore? Nëse po, çfarë lloj masash?
- A janë marrë masa përmirësuese për të trajtuar pasojat e dëmshme? Nëse jo, pse jo?
- A raportoi personi përgjegjës (p.sh. zyrtari që mori dijeni për veprën) për shfaqjen e ndotjes tek autoriteti i duhur? A u dorëzua raporti pas një vonese që çoi në humbjen e provave (deficiti i informacionit)?
- A ka ndonjë dëshmitar të veprës mjedisore?

Veprimet fillestare që mund të kryhen deri në ardhjen e organeve të ndjekjes penale përfshijnë ndërmarrjen e veprime për të përcaktuar burimin e ndotjes, si më poshtë:

- identifikimi i pikës më të largët të ndotjes;
- mbajtja e një procesverbali;
- fotografimi, skicimi dhe dhënia e një përshkrimi të hollësishëm të të gjitha zonave të ndotura;
- sigurimi i një analize të hollësishme të vendeve të vendosura në afërsi të burimit të ndotjes; dhe
- duke dhënë një përshkrim të hollësishëm të gjendjes së zonës që rrethon burimin e menjëhershëm të ndotjes.

Llojet e ndryshme të ekspertizës që mund të përdoren gjatë procedurës së kontrollit apo hetimit, përshkruhen më poshtë. Roli i NjQV-së në këtë rast është të informojë autoritetin përgjegjës nëse nuk e kryen vetë këtë proces.

- Kampionimi ose ekzaminimi i tokës

Marrja e mostrave të tokës është një proces shumë i ndërlikuar, pasi toka e ndotur mund të preket nga erozioni, oksidimi, ndikimet meteorologjike dhe kimike, flora dhe fauna, aktiviteti njerëzor etj. Në çdo rast, ky proces duhet të kryhet nga autoritetet që e kanë për detyrë të bëjnë një gjë të tillë. Në këtë rast, skena duhet të ndahet në seksione për analiza të veçanta. Një mostër prej 100 deri 200 gramë tokë duhet të merret nga secili metër katror dhe të paketohet në një enë të pastër me tregues të saktë të vendndodhjes nga e cila është marrë kampioni. Është thelbësore mbajtja e një procesverbali të procesit të marrjes së mostrave të tokës, duke përdorur fotografi, skica dhe shënime të shkruara.

- Kampionimi dhe/ose ekzaminimi i ujit⁵

Për analiza fizike dhe kimike, mostrat e ujit të pijshëm ose jo duhet të merren si më poshtë:

Së pari, uji duhet të lejohet të rrjedhë për pesë minuta. Pastaj, duhet të mbushet pjesërisht në një enë e pastër, duke lënë një hapësirë në mënyrë që të mund të mbyllet fort. Kontejnerët duhet të jenë të

5 https://www.who.int/water_sanitation_health/dwq/2edvol3d.pdf

etiketuar qartë me emrin e objektit ku është marrë kampioni, vendin, datën dhe orën e marrjes së mostrave dhe llojin e analizave të kërkuara (p.sh. klorin dhe mikroorganizmat). Nëse nuk kërkohet ndonjë analizë e posaçme, do të kryhet një analizë themelore.

Mostrat e ujit të lumenjve duhet të përfshijnë sedimente nga fundi i shtratis të burimit ujqor, të cilat duhet të analizohen për të evidentuar llojin dhe sasinë e ndotësve, siç janë metalet e rënda, vajrat minerale, pesticidet dhe fenolet. Hetimi duhet të përfshijë transmetimin e ndotësve dhe bashkëveprimin ndërmjet ndotësve dhe mjedisit në mënyrë që të përcaktojë se si ndryshon përbërja e ujit kur depërton nëpër seksione të ndryshme të burimit ujqor.

Një analizë tjetër që mund të bëhet është analiza e rrjedhës së ujit e cila përdoret për të ekzaminuar praninë dhe përhapjen e ndotësve. Në këtë rast, një lëng me ngjyrë shtohet në rrjedhën ujqore në mënyrë që të mund të monitorohet rrjedha dhe depërtimi i ujit. Kjo metodë mund të përdoret, për shembull, për të përcaktuar nëse një shkelës i dyshuar në fakt ka qenë në gjendje të shkaktojë ndotjen, duke marrë parasysh mundësitë e tyre për të hyrë në vendin ku ka ndodhur ndotja.

- Ndotja e ajrit⁶

Përveç përdorimit të sondave speciale të vendosura në vendndodhje specifike për të përcaktuar praninë e emetimeve të ndotësve në ajër, mostrat e ajrit të ndotur mund të sigurohen duke pompuar ajrin në kontejnerë të veçantë që më pas dërgohen në laborator për analiza, ose duke kaluar ajër nëpër filtra të veçantë në cilat depozitohen dhe identifikohen ndotësit. Kjo procedurë nuk mund të përdoret në rastin e ndotësve të gaztë, pasi ato nuk bllokohen nga filtrat, ndryshe nga lëndët e grimcave.

Po ashtu në kuadër të ekzaminimit të ndotjes së ajrit, është e rëndësishme të merret në analizë për shembull bimësia e prekur. Gjatë procesit të marrjes së mostrave, duhet të merret në konsideratë ndjeshmëria e materialit bimor, pasi mostrat do të preken nga prania

6 [https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/ambient-\(outdoor\)-air-quality-and-health](https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/ambient-(outdoor)-air-quality-and-health)

e mikroorganizmave, proceset e kalbjes, tharjes si dhe të humbjes së karakteristikave tipike që do t'i bënin mostrat të papërdorshme. Prandaj, mostrat duhet të dorëzohen në laborator për analizë sa më shpejt që të jetë e mundur, ose ekspertiza duhet të kryhet në vend.

Hapi 4 – Vendosja e sanksionit administrativ

Autoriteti përgjegjës për vendosjen e sanksionit administrativ në këto raste është Inspektorati përgjegjës për mjedisin (sot Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit). Megjithatë, NjQV-të duhet të ndihmojnë me grumbullimin e informacionit të cituar më sipër në këtë Udhëzues. Po ashtu, në Kreun III të këtij Udhëzuesi janë identifikuar rastet kur edhe Bashkia vendos masë administrative.

Hapi 5 – Kallëzimi penal

Kallëzimi penal është mjet që përdoret njësoj për çdo finalizim procedure standarde operacionale dhe rrjedhimisht, në këtë Udhëzues, duhet të shihet si i njëjtë dhe i përdorshëm për të tre llojet e PSO-ve.

Për rastet e ndotjes apo dëmtimin e mjedisit në përgjithësi (ajrit, ujit, tokës, pyjeve, faunës e florës etj.) të cilat përbëjnë vepër penale, sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin penal, punonjësit e bashkisë, në cilësinë e nëpunësit publik, kanë detyrimin që të bëjnë kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ose Policinë Gjyqësore (në Policinë e Shtetit ose në Prokurori). Ky detyrim buron nga neni 281 i Kodit të Procedurës Penale⁷ i cili përcakton se kallëzimi penal kryhet edhe kur nuk është individualizuar personi të cilit i atribuohet vepra penale. Ai që paraqet kallëzimin ka të drejtë të kërkojë një vërtetim, në të cilin tregohet personi që e ka marrë dhe koha e saktë e paraqitjes. Formulari standard i kallëzimit është bashkëlidhur si **Shtojca II** e këtij Udhëzuesi.

Kallëzimi nga nëpunësi publik duhet të bëhet me shkrim dhe detyrimisht duhet të përmbajë:

⁷ Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.

- elementet thelbësore të faktit;
- burimet e provës;
- gjeneralitetet;
- banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të cilit i atribuohet fakti;
- banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e personit të dëmtuar;
- banimin dhe çdo gjë tjetër që vlen për identifikimin e atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit.

Kur gjatë një procedimi civil ose administrativ zbulohet një fakt që përbën veprë penale që ndiqet kryesisht, organi përkatës bën kallëzim në Prokurori.

Mungesa apo pasaktësia e këtyre kriterëve në kallëzim bëhen shkak për kthimin e materialit tek kallëzuesi për plotësim. Në qoftë se gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve të tij, nëpunësi i NjQV-së që nuk raporton ose nuk kallëzon një veprë të caktuar, do të mbajë përgjegjësi penale për veprën e “moskallëzimit të krimit” që është duke u kryer apo që është kryer. Sipas nenit 300 të Kodit Penal, moskallëzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Në qoftë se gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve a të shërbimit të tyre, nëpunësi i NjQV-së, ndryshon vendin e kryerjes së veprës penale duke prishur, ndryshuar apo fshirë gjurmët e saj ose duke lëvizur, fshehur, asgjësuar, vjedhur, falsifikuar një send apo një dokument me qëllim për të vështirësuar dhe penguar zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj, ai do të mbajë përgjegjësi penale për veprën e “veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, parashikuar në nenin 301 të Kodit Penal. Ky nen përcakton se kryerja e veprimeve për të ndryshuar vendin e kryerjes së veprës penale duke prishur, ndryshuar apo fshirë gjurmët e saj ose duke lëvizur, fshehur, asgjësuar, vjedhur, falsifikuar një send apo një dokument me qëllim për të vështirësuar dhe penguar zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.



Autor: Romina Idrizi, përgatitur në kuadër të Konkursit Studentor të Artit Pamor
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2018

PSO 2: Mbrojtja e natyrës dhe pyjeve

Duke qenë së NjQV-të kanë kompetenca të zgjeruara të menaxhimit të pyjeve, skemën për monitorimin afatgjatë të kushteve të pyjeve, për vazhdimësinë dhe zhvillimin e mëtejshëm, masat për mbrojtjen e pyjeve dhe të mjedisit pyjor nga ndotja atmosferike, ruajtjen e ekuilibrave të sistemeve ekologjike natyrore, si dhe masat parandaluese nga zjarri, e logjikshme do të kishte qenë të kishin dhe kompetencën për inspektimin e tyre. NjQV-të nuk kanë tagër të marrin masa administrative ndaj shkelësve për shkaktimin e kundërvajtjeve në sektorin e pyjeve dhe kullotave, por janë të detyruara ligjërisht që pas konstatimit të një kundërvajtje të njoftojnë Policinë Pyjore për vendosjen e masave administrative ndaj shkelësve. Natyrisht raportimi në Policinë Pyjore nuk i përjashton Bashkitë nga detyrimi për të ndjekur procedurat ligjore të raportimit dhe kallëzimit të një vepre penale.

PSO-të për natyrën dhe pyjet ndjekin të njëjtat hapa sikurse edhe ato që pamë për ndotjen, por në këtë rast barrën kryesore të konstatimit dhe veprimit e mbajnë strukturat e shërbimit pyjor në Bashki. Gjatë punës së tyre kontrolluese, strukturat e shërbimit pyjor mund të përdorin të njëjtat formate standarde si ato që përdoren për dokumentimin e aktiviteteve të inspektimit⁸ në Republikën e Shqipërisë, përcaktuar sipas Urdhrit Nr. 58/1, datë 22.01.2015 “Për disa ndryshime të Urdhrit Nr. 58, datë 08.21.2014, “Për miratimin e formatit standard të dokumentimit të aktiviteteve të inspektimit në Shqipëri”.

Një ndër metodat për zbulimin e shpyllëzimit apo dëmtimin e pyjeve në praktikë është zbulimi i prerjeve të paligjshme të cilat janë evidente dhe duken qartësisht. Prerja e pastër është e lehtë për t’u zbuluar. Bëhet duke vizituar territorin. Është shumë e rëndësishme që dëmtimet të zbulohen menjëherë në mënyrë që të mund të ndalen sa më shpejt që të jetë e mundur, të mblidhen provat dhe autorët të ndëshkohen.

8 Psh. Ligji Nr. 10006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar parashikon se veprimtaria kontrolluese e cila kryhet dhe nga bashkitë, ushtrohet në përputhje me këtë ligj, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe dispozitat e tjera në fuqi.

Me qellim përcaktimin e shkallës së dëmtimit të pyjeve, secila bashki mund të ndërtojë një metodologji të vetën ku mund të shtrohen këto pyetje:

- Sa është masa e pemëve dhe bimëve të shkultura/prera, dëmtuara?
- Sa përqind e pemëve janë hequr?
- A janë kryer prerjet në përputhje me planet e menaxhimit si një formë e rregullt e rigjenerimit të pyjeve?
- A është kryer prerje e pyjeve për të ndryshuar përdorimin e tokës me pëlqimin e autoriteteve apo sipas lejeve të veçanta?

Më pas duhet të vijohet me mbledhjen e provave që duhet të sigurohen dhe paraqiten për evidentim dhe trajtim ligjor kundër dëmtimit dhe shkatërrimit të fondit pyjor. Këto të drejta i janë besuar Policisë pyjore sipas ligjit, por strukturat e shërbimit pyjor në Bashki kanë kompetenca të plota monitoruese dhe kontrolluese, çka krijon hapësirë për hetim fillestar.

1. Procedura e marrjes së informacionit dhe kontrollit

Kryerja e kontrollit të fondit pyjor dhe kullësor kryhet nga vetë strukturat e shërbimit pyjor dhe kullësor. Kur ka informacione të besueshme për shkelje, atëherë mund të kërkohet kontroll i përbashkët së bashku me Policinë Pyjore të zonës. Kontrollët mund kryhen edhe për aktivitetet e vjeljes apo të transportit të produkteve jo-drusore, si bimë mjekësore, bimë aromatike, pemë frutore etj.

Çdo punonjës i bashkisë mund të përballet me situatat e mëposhtme:

- Nëse personi është kapur në vend ndërsa kryen prerje të paligjshme. Në këtë moment duhet identifikuar personi i kapur në veprim dhe përveç regjistrimit të të dhënave personale, të mbliidhen informacionet përkatëse (d.m.th. vendi, data dhe ora e prerjeve, dëshmitarët). Të gjitha të dhënat duhet të skedohen

në një regjistër dhe t'i dorëzohen Policisë Pyjore.

- Nëse personi nuk është kapur duke kryer veprën, por dëmtimi i pyjeve diktohet më vonë, dhe nëse ka indikacione, dëshmitarë ose prova të tjera në lidhje me autorin e veprës, punonjësi i bashkisë mund të mbledhë të dhëna personale nga dëshmitarët, nëse ata pranojnë të japin informacion dhe të dëshmojnë vullnetarisht. Po ashtu, mund të mblidhen dhe përshkruhen të gjitha provat e tjera që mund të jenë mbledhur gjatë kontrollit. Të gjitha të dhënat duhet të skedohen në një regjistër dhe t'i dorëzohen Policisë Pyjore.
- Nëse personi nuk është kapur në vend dhe nuk ka indikacione për identitetin e tij/saj si autor i veprës, duhet të mblidhen sa më shumë informacione që mund të përdoren më tej nga organet hetimore për të kryer hetime të mëtejshme dhe për të identifikuar autorët.

Në rastet kur ka rezistencë nga pala e shkelësve dhe strukturat e shërbimit pyjor dhe kullor e vlerësojnë këtë të fundit me pasoja të rënda për ushtrimin normal të detyrës, ato duhet të njoftojnë menjëherë përfaqësuesin Policinë Pyjore, pjesë e Inspektoratit përgjegjës për pyjet ose kur kjo është e pamundur të njoftojnë menjëherë Policinë e Shtetit nëpërmjet numrit të emergjencës 112.

2. Faza e mbledhjes së të dhënave në terren

- Përcaktimi i vendndodhjes

Vendndodhja e prerjeve duhet të përshkruhet për sa i përket pozicionit të saj, prirjes, llojit të pemës ose bimësisë së dëmtuar, mjeteve të prerjes/shkatërrimit, mjeteve të transportit, gjendjes së pyllit pas prerjes etj. Duhet të regjistrohet dhe evidentohet nëse ndonjë lloj produkti druri është hequr/larguar nga pylli. Nëse, në vendin e prerjeve ose pranë tij, gjenden disa produkte druri që nuk janë transportuar, këto produkte duhet të maten dhe të shënohen. Këto të dhëna, së bashku me të dhënat

e tjera të mbledhura, duhet t'u dorëzohen Policisë Pyjore. Dëmet e tjera të shkaktuara ndaj rrugëve pyjore dhe shtigjeve të pyllit, ndaj bimëve të mbrojtura, specieve shtazore dhe habitateve të tyre, etj., gjithashtu duhet të identifikohen dhe regjistroheshin. Duhet të bëhen gjithashtu fotografime të vendngjarjes, në mënyrë që të vërtetohet shkalla e dëmtimit të shkaktuar ose të identifikohet kundërvajtësi.

- Llogaritja e të dhënave

Llogaritja e të dhënave duhet të përfshijë llogaritjen e vëllimit, një vlerësim të strukturës së fondit pyjor dhe kullësor, vlerësimet e vlerës së drurit të prerë, vlerën e rendimentit të humbur dhe një vlerësim të dëmit mjedisor, si dhe dëmeve të tjera të shkaktuara. Llogaritjet duhet të bëhen nga inxhinierë kompetent.

- Përcaktimi i vlerës së të dëmeve

Ky hap është i rëndësishëm sidomos për të pretenduar në një fazë të dytë pagesën e dëmit nga kundërvajtësi (*shih pjesën IV. 2 të këtij Udhëzuesi*). Dëmet mund të identifikoheshin në infrastrukturën pyjore, përfshirë rrugët pyjore, shtigje të ndryshme etj. Kundërvajtësit do të jenë përgjegjës të paguajnë kompensimin për një dëm të tillë dhe të rimbursojnë shpenzimet e bëra gjatë rikthimit në gjendjen fillestare të zonës.

Kostot e rikthimit në gjendjen fillestare duhet të paraqiten financiarisht dhe materialisht dhe duhet të mbulojnë fushën e të gjithë punës që duhet të ndërmerret, përfshirë kostot për materiale, makineritë dhe burimet njerëzore. Për të bërë vlerësimin, duhet të përdoren çmimet e tregut apo ato referencë, nëse ka. Megjithatë kjo fazë i takon një procesi të rregullt ligjor.

- Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi me autoritetet e tjera

Të gjithë zyrtarët përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve, janë përgjegjës edhe për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për pyjet. Në punën e përditshme të mbrojtjes së pyjeve, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve

kompetente është i rëndësishëm, në mënyrë që të sigurohet vendosja e sanksioneve për veprimtari të paligjshme. Bashkëpunimi me organet e tjera mund të jetë zyrtar ose jozyrtar.

Bashkëpunimi zyrtar vendoset në rastin e shkeljeve të rënda, kur përgatiten hetime të mirëfillta, ose nëse autoriteti përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve shfaq nevojën për bashkëpunim. Ky lloj bashkëpunimi kryhet me shkrim dhe pasohet nga arkivimi i akteve, provave, kërkesave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme.

Bashkëpunimi jozyrtar merr formën e komunikimit të zakonshëm përmes telefonit, postës elektronike ose bisedës ballë për ballë. Ky lloj komunikimi mund të përfshijë shkëmbimin e përvojave dhe dhënien e këshillave ose rekomandimeve.



Autor: Marinela Mino, përgatitur në kuadër të Konkursit Studentor të Artit Pamor
Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2018

PSO 3: Kontrolli i mbetjeve, përfshirë mbetjet spitalore dhe ato të rrezikshme

Procedurat e përcaktuara në këtë PSO përshkruajnë:

- zbulimin e mospërputhshmërisë, dëmit mjedisor dhe veprave të mundshme penale ose kundërvajtjet e kryera në fushën e mbetjeve;
- vlerësimin e riskut dhe/ose dëmit dhe mbledhjen e provave;
- caktimi i masave parandaluese dhe rehabilituese.

1. Zbulimi i mospërputhshmërisë, dëmit mjedisor dhe veprave të mundshme penale ose kundërvajtjet e kryera në fushën e mbetjeve

Përveç Inspektoratit, institucionet e tjera si Policia e Shtetit, Policinë Bashkiake, qytetarët dhe organizatat jo-qeveritare mund të konstatojnë dhe raportojnë shkelje të mundshme të legjislacionit për menaxhimin e integruar të mbetjeve, çka mund të sjellë edhe shkaktimin e një vepre penale kundër mjedisit.

Mbikëqyrja e inspektimeve për zbatimin e legjislacionit sektorial bëhet sipas ligjit për inspektimin, nëpërmjet inspektimeve të rregullta sipas planit përkatës të inspektimit; dhe inspektimeve ad-hoc të cilat marrin shkas nga shqetësimet e shfaqura prej qytetarëve dhe raportimet e marra nga institucionet e tjera, të gjitha llojet e tjera të informacionit për mosrespektimin e Ligjit, si dhe çdo rast tjetër të incidenteve mjedisore. Pikërisht duke pasur parasysh atë që Inspektoratet bëjnë, çdo nëpunës i bashkisë mund të japë informacion dhe të raportojë situatat e ndryshme që përbëjnë vepra penale. Ky detyrim mund të shtrihet edhe si detyrim kontraktor për kompanitë e licencuara dhe kontraktuara nga bashkitë për grumbullimin dhe përpunimin e mbeturinave.

2. Vlerësimi i riskut dhe dëmeve dhe mbledhja e provave

Duke qenë se bashkitë janë përgjegjëse për marrjen e masave ose

për procesin e pastrimit dhe nuk kanë kompetenca inspektuese, ato, nëpërmjet strukturave të tyre të kontrollit, mund të japin ndihmë aktive dhe të menjëhershme kur është e domosdoshme në interes të shëndetit të qytetarëve dhe mjedisit.

Nëse gjatë një procedure kontrolli ose thjesht pas një konstatimi, nëpunësi i Bashkisë konstaton se legjislacioni është shkelur, ose nuk është zbatuar në mënyrën e duhur, ky i fundit duhet të raportojë menjëherë tek Inspektoratet që mbulojnë fushën e mbetjeve (sipas llojit të ndotjes nga mbeturinat mund të jenë: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit; Drejtoria e Shërbimit Veterinar; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit; Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor). Megjithatë, nëse konstatohet një vepër penale, nëpunësi duhet të ndërmarë të gjitha masat për të siguruar provat e veprës penale, objektet mbi të cilat është kryer vepra penale, prova të tjera dhe të informojë Prokurorinë ose Policinë e Shtetit për çështjen. Kontrollori vlerëson në mënyrë të pavarur se cilat prova do të përdoren për të vërtetuar faktet kryesore por nuk i prek ato, thjesht ja tregon organeve ligj zbatuese.

3. Rikuperimi i kostove dhe detyrimet mjedisore

Ndotësi do të rimbursojë çdo kosto e cila vjen nga ndotja e mjedisit në përputhje me parimin “ndotësi paguan”. Prodhuesi ose mbajtësi i mbeturinave duhet të mbulojë kostot e parandalimit dhe kostot e rikuperimit dhe deponimit të mbeturinave, përfshirë kujdesin e duhur dhe monitorimin. Prodhuesit janë gjithashtu përgjegjës financiarisht për masat parandaluese dhe restauruese në rast se ato shkaktojnë ose ka të ngjarë të shkaktojnë dëme të mjedisit.

Prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave janë përgjegjës për të gjetur zgjidhjen më të përshtatshme për mjedisin, në përputhje me karakteristikat e prodhuesit dhe teknologjive prodhuese, duke përfshirë dhe qasjen e ciklit jetësor dhe përdorimin në mënyrën më efektive të teknologjive të caktuara. Prodhimi i mbeturinave duhet të shmanget, ose të paktën sasia dhe dëmi i mbeturinave të prodhuara duhet të minimizohen, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku për shëndetin e

njeriut dhe mjedisin dhe të shmanget degradimi i mjedisit. Prodhuesit dhe mbajtësit e mbeturinave, të cilët asgjësojnë mbeturinat në pronën e tyre dhe/ose lejojnë një tjetër person juridik ose fizik të kryej këtë aktivitet, janë të detyruar t'i largojnë dhe t'i asgjësojnë mbeturinat me shpenzimet e tyre vetjake.

Bashkia ka përgjegjësinë të ndërmarrë detyra të drejtpërdrejta për menaxhimin e mbetjeve duke i dhënë përparësi veprimeve emergjente të pastrimit, në rast se personi përgjegjës nuk mund të identifikohet dhe kërkohet veprim i drejtpërdrejtë dhe i shpejtë në interes të mbrojtjes së shëndetit të njeriut, florës dhe faunës, si dhe mjedisit. Kjo dispozitë nuk përjashton kërkimin e veprimeve korrigjuese dhe rikuperimin e kostos.

IV.2. Të drejtat e bashkisë për të kërkuar dëmin e shkaktuar

Gjatë procesit penal, NjQV-ja, si subjekti i dëmtuar nga vepra penale të ndryshme, gëzon një sërë të drejtash, të cilat janë të përcaktuara në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale dhe në nene të tjera të këtij Kodi, sikurse janë:

- të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor. Kërkesë që duhet të kryhet bazuar në nenet 105, 110 dhe 279/a të Kodit të Procedurës Penale ;
- të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrijë kërkesa të tjera përpara organit procedues. Kërkesë që duhet të kryhet bazuar në nenin 110 të Kodit të Procedurës Penale;
- të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimimin e tij/saj, në kushtet e caktuara në këtë Kod. Kërkesë që duhet të kryhet bazuar në nenin 279/a të Kodit të Procedurës Penale.
- të njoftohet për mos fillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjyqimit. Njoftim që i bëhet nga organi i procedues në bazë të neneve 291/1, 327 e 329 të Kodit të Procedurës Penale;

- të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen. Ankimi bëhet në bazë të neneve 291 dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale;
- të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal. Kërkesë që duhet të kryhet bazuar në nenin 61 të Kodit të Procedurës Penale;
- të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;
- të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

Në rastet kur ka pësuar dëm nga vepra penale, Bashkia mund të paraqesë padi civile⁹ në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit. NJQV legjitimohet nga organi procedues, derisa të mos ketë filluar shqyrtimi gjyqësor¹⁰. Në rastet, kur pas vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi i pushimit nuk është i bazuar, Bashkia, në cilësinë e të dëmtuarit, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë për revokimin e vendimit të pushimit. Kërkesa, së bashku me aktet dhe provat e reja, depozitohet në sekretarinë e gjykatës, në bazë të nenit 329/c të Kodit të Procedurës Penale.

Kundër vendimit të mospranimit ose të rrëzimit të kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit, Bashkia, në cilësinë e të dëmtuarit, bazuar në nenin 329/ç të Kodit të Procedurës Penale, ka të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, e cila shqyrton ankimin në dhomë këshillimi.

9 Neni 61 i Kodit të Procedurës Penale

10 Neni 62 i Kodit të Procedurës Penale

SHTOJCA I

Baza ligjore e kompetencave të pushtetit vendor

Funksioni	Baza Ligjore
Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta shtëpiake	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 8094, datë 21.3.1996 “Për largimi publik të mbeturinave”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 175, datë 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe të planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 418, 25.06.2014 “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 452, 11.07.2012 “Për lendfillet e mbetjeve”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 608, 17.9.2014 “Për përcaktimin e masave të nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 177, 06.03.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Udhëzimi Nr. 6, datë 27.11.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”; <input type="checkbox"/> Udhëzim Nr. 1738, datë 12.3.2015 “Për kriteret e studim-projektimit për rehabilitimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të ngurta urbane, si dhe ndërtimin e lendfilleve apo impianteve të trajtimit të mbetjeve të ngurta urbane”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Rregullore Nr. 1, datë 30.3.2007 e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit “Për trajtimin e mbetjeve nga ndërtimi dhe shkatërrimet, që nga krijimi dhe transporti i tyre për asgjësim”; <input type="checkbox"/> Udhëzim Nr. 6, datë 27.11.2007 i Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 806, datë 4.12.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave e procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi”; <input type="checkbox"/> Rregullorja Nr. 4, datë 15.10.2003 e Ministrit të Mjedisit “Për kërkimin, shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të eksportimit dhe të transmetimit të mbetjeve”. <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 509, datë 13.9.2017 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 504, datë 13.9.2017 “Për Përcaktimin e Fushës së Përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 431, datë 11.7.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbetjeve”; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 46, datë 29.1.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave”.

Planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 1096, datë 28.12.2015, “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 671, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”; <input type="checkbox"/> Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 01, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Vendimi i Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 17, datë 07.06.2016 “Për shqyrtimin e kërkesave për leje zhvillimi dhe ndërtimi brenda zonave të rëndësishme kombëtare”, i ndryshuar. <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 73, datë 7.2.2018 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018–2027”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 655, datë 18.12.2002 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtare të planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 531, datë 01.08.2003 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile”; <input type="checkbox"/> Ligj Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 408 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 408 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territori”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 1096, datë 28.12.2015 “Për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 671, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”.
--	---

<p style="text-align: center;">Funksionet e bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit</p>	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 10431, 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 9774, 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 9774, 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar me ligjin Nr. 39/2013; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 633, datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 908, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 352, 29.04.2015, “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 246, 30.04.2014 “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 177, 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zoonimit të mjediseve ujore pritëse»; <input type="checkbox"/> Udhëzim Nr. 8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.
<p style="text-align: center;">Administrimin, shfrytëzimin dhe mbrojtja e tokës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 121 datë 17.02.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 64, datë 23.1.2003 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve të seksioneve të administrimit dhe të mbrojtjes së tokës, në këshillat e qarqeve dhe të zyrave të menaxhimit dhe të mbrojtjes së tokës, në komuna dhe/ose”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> Ligji Nr. 9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 59, datë 28.1.2005 “Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore”; <input type="checkbox"/> VKM Nr. 80, datë 28.1.2005 “Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore”;

Administrimi i shërbimit pyjor dhe kullësor vendor

- Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullësor”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 5/2016, datë 4.2.2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje”;
- VKM Nr. 814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030”;
- VKM Nr. 433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të pyjeve dhe kullotave, bashkive”;
- VKM Nr. 632, datë 11.06.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje”;
- VKM Nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës dhe procedurave të heqjes nga fondi pyjor”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1374, datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës dhe procedurave të heqjes nga fondi kullësor” i ndryshuar;
- VKM Nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për caktimin e vlerës së dëmit në fondin kullësor”;
- VKM Nr. 438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjen e materialit drusor”;
- VKM Nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijim e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve”;
- VKM Nr. 22, datë 09.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”;
- VKM Nr. 48, datë 31.1.2007 “Për përcaktimin e rregullave për mbajtjen, përbërjen, afatet e përdorimit e të zëvendësimit të uniformës dhe të pajisjeve e të mjeteve të tjera, në përdorim të punonjësve të shërbimit pyjor”;
- Udhëzimi Nr. 2, datë 3.3.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”;
- Udhëzim Nr. 4, datë 12.9.2008 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor”;
- Udhëzimi Nr. 2, datë 20.7.2017 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie e tyre për kullotje dhe kullotje”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit shqyrtimit dhe kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 26.1.2017 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor”;
- Udhëzimi Nr. 4, datë 25.8.2010 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, i ndryshuar;
- Udhëzim Nr. 4, datë 25.8.2010 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”.

Mbrojtja e Natyrës dhe e Biodiversitetit

- Ligji Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 81 datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”;
- Ligji Nr. 9244 datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 8905, datë 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve”;
- VKM Nr. 31, datë 20.1.2016 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”;
- Ligji Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji Nr. 91 datë 28.02.2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”;
- Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- Ligji Nr. 10 120, datë 23.4.2009 “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”;
- Ligj Nr. 75/2016 Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të kombeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike;
- VKM Nr. 762, datë 16.9.2015 “Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”;
- Ligji Nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10 390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”;
- Ligji Nr. 8531, datë 23.9.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike”;
- Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullisor” i ndryshuar;
- Ligji Nr. 5/2016, datë 4.2.2016 “Për shpalljen e moratoriumit në pyje”;
- VKM Nr. 814, datë 31.12.2018 “Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019-2030”;
- VKM Nr. 391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, i ndryshuar;
- VKM Nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për caktimin e vlerës së dëmit në fondin kullisor”;
- VKM Nr. 438, datë 8.6.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjen e materialit drusor”;
- VKM Nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota, si dhe për krijim e njësisë vullnetare të shuarjes së zjarreve”;
- VKM Nr. 22, datë 09.1.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”;
- Udhëzimi Nr. 2, datë 3.3.2017 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grup ngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtimit me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje”;
- Udhëzimi Nr. 2, datë 20.7.2017 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënie e tyre për kullotje dhe kullotje”;
- Udhëzimi Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat procedurat e kërkimit shqyrtimit dhe kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullisor publik”;
- Udhëzimi Nr. 4, datë 25.8.2010 “Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave e grup ngastrave për shfrytëzim, rregullat për vjeljen e materialit drusor dhe shitjen me ankand të lëndës drusore e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, i ndryshuar.

Të Tjera	<ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> Ligj Nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”;<input type="checkbox"/> Ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, i ndryshuar.
-----------------	---

SHTOJCA II

Kallëzimi nga nëpunësit publikë

Emërtesa e institucionit: _____, përfaqësuar nga (emër, mbiemër) _____, me funksion/detyrë _____, adresa (e plotë) _____

Në kallëzim përfaqësuesi i institucionit tregon:

Rrethanat e veprës penale, burimin/burimet nga ka ardhur në dijeni për veprën penale, për gjeneralitetin, banimin dhe adresën e personit të cilit i atribuohet fakti, të personit të dëmtuar dhe atyre që janë në gjendje të sqarojnë rrethanat e faktit, provat që disponon dhe burimi i tyre, data, vendi, ora e ngjarjes, etj.

Vendi ku bëhet kallëzimi (qyteti) _____, data _____.

KALLËZUESI

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi i përfaqësuesit të institucionit)